



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
KUVENDI KOMUNAL - MALSHEVË/QKMF "Dr. SHPËTIM ROBAJ" NË MALISHEVË

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore.

Në bazë të nenit 67 dhe 68 të Ligjit për Zyrtarët Publik Nr. 06/L-114, të nenit 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, në bazë të nenit 4 të Udhëzimit Administrativ nr. 07/2017 si dhe në bazë të Statutit të QKMF-së nenit 10. Drejtori Dr Afrim Krasniqi shpall:

KONKURS INTERN (I MBREDSHËM) PËR PLOTSIMIN E VENDIT TË PUNËS.

Pozita: Koordinator për ngritjen e Cilësisë dhe Shërbimeve në QKMF.

Institucioni:	Komuna e Malishevës
Departamenti/ Drejtoria:	Drejtoria Për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale- QKMF
Lloji i pozitës:	Nëpunës i Shërbimit Publik
Numri i Pozitave	(1) Një.
Titulli i mbikëqyrësit	Drejtori i QKMF-së
Kohëzgjatja e emërimit	Me kohë të caktuar (4) katër vite

Kushtet e veçanta të Konkursit:

- Specialist ose Mjek i Praksës së Përgjithshme.

Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për pranimin e zyrtarëve publikë

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
- Të zotëroj njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët.
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore.
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale.
- Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik.

Detyrat e Punës:

- Përpilon, vlerëson dhe koordinon planin dhe programin institucional për cilësi dhe siguri të shërbimeve shëndetësore;
- Bashkëpunon me drejtorin e QKMF-së dhe inicion themelimin e komitetit të cilësisë, komisioneve të tjera si atë për audit klinik dhe hulumtim, organizim të rishqyrtimit kolegjial, dhe të ngjashme, të përcaktuara me statut apo akte nënligjore të niveleve të kujdesit shëndetësor;
- Mbikëqyrë zbatimin e dokumenteve të cilat sigurojnë praktikën e mirë mjekësore;
- Monitoron zbatimin e standardeve të cilësisë;

- Evidenton mangësitë dhe propozon masat për përmirësimin e cilësisë dhe sigurisë së shërbimeve shëndetësore;
- Siguron shërbime konsultative sipas statutit të QKMF-së, për trupat menaxhuese, profesionistët shëndetësor dhe bashkëpunëtorët profesional dhe jo profesional, me qëllim të zbatimit të standardeve të cilësisë dhe sigurisë së shërbimeve shëndetësore;
- Përcjellë zhvillimet e reja në fushën e cilësisë dhe sigurisë së shërbimeve shëndetësore;
- Bashkëpunon me të gjitha komisionet e institucionit për cilësi dhe siguri të shërbimeve shëndetësore;
- Menaxhon dosjet e komitetit të sigurisë dhe cilësisë për institucionin shëndetësor;
- Harton raporte periodike për drejtorin e institucionit shëndetësor;
- Harton raportin vjetor dhe përmes drejtorit të institucionit shëndetësor e përcjell në DCSShSh në Ministrinë e Shëndetësisë

Përgjegjësitë:

Sipas Ligjit të Punës dhe Ligjit për Shëndetësi si dhe Udhëzimeve Administrative dhe Rregulloreve në Fuqi.

Dokumentet e nevojshme:

- Diploma dhe kualifikimet përkatëse.
- Licencën e punës
- Formulari i aplikimit i plotësuar
- Rezumeja personale (CV)
- Letërnjoftimin të fotokopjuar .
- Përvoja e punës (së paku 3 tri vite)

Dokumentet duhet të jenë në kopje dhe ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen në rastin e intervistimit.

Afati dhe mënyra e aplikimit:

30 ditë nga dita e publikimit të konkursit mbetet vetëm njoftim, ndërsa konkursi mbetet i hapur 8 ditë, aplikacionet dorëzohen nga **data: 25.02.2022 deri me dt: 01.03.2022** Aplikacionet merren dhe dorëzohen në zyrën e personelit në QKMF (ditëve të punës prej: 07 deri ora 15).

-Kërkesat e dërguara pas datës së fundit dhe kërkesat e pa kompletuara nuk do të pranohen.

QKMF-Malishevë
Dt: 25.01.2022



Drejtori:
Dr. Afrim Krasniqi, Spc. Mjek Familjar